



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke u mbështetur në Udhëzimin administrativ nr. 14/2017, datë 06.12.2017:

SHPALL
KONKURS
PËR NDARJE TË BURSA PËR STUDENTËT E UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË
PROGRAMET: BAÇELOR DHE MASTER, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019

Kushtet dhe kriteret

1. Për fitimin e bursës së MASHT, kandidatët duhet ti plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të kenë notën mesatare të studimeve së paku 9.0.
 - 1.3. Të kenë përfunduar vitin e parë në studimet BA dhe MA;
 - 1.4. Të jenë studentë të këtyre fushave të studimit:
 - Bujqësi - Veterinari
 - FSHMN
 - Mjekësi
 - Teknik
 - Shkenca të aplikuara
 - Edukim
 - Arte
 - Edukatë Fizike
 - 1.5. Për nivelin Master kandidati duhet të sjellë së paku dy (2) referenca të nënshkruara nga profesorët, me të cilat dëshmohet merita dhe kompetenca e kandidatit.

Kategoritë e studentëve me përparësi

1. Kategoritë e kandidatëve që do të kenë përparësi për fitimin e bursës nga MASHT, në kushte të barabarta me studentët tjerë janë:
 - 1.1. Fëmijët e dëshmorëve të luftës së UÇK-së;
 - 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe fëmijët e tyre;
 - 1.3. Veteranët e luftës së UÇK-së dhe fëmijët e tyre;
 - 1.4. Fëmijët e të zhdukurve të luftës;
 - 1.5. Fëmijët e familjeve që janë përfitues të skemave sociale;
 - 1.6. Fëmijët e ish të dënuarve, të burgosurve dhe të përndjekurve politik.
 - 1.7. Fëmijët të cilët janë më tepër se një student nga një familje.
 - 1.8. Rregullat e përcaktuar në Kategoritë e studentëve me përparësi në kushte të barabarta nuk vlejnë për Studentët me aftësi të kufizuara

Dokumentacioni që kërkohet:

1. Kërkesa/aplikacioni nga MASHT, i cili mund të shkarkohet në linkun e MASHT-www.masht.gov.net, për bursë drejtuar MASHT,
2. Certifikata e lindjes origjinale,
3. Vërtetimi i statusit të studentit i vitit akademik 2018-2019.
4. Certifikata e vërtetuar e notave nga fakulteti për dy nivelet e studimit (Ba dhe Ma), me notë mesatare të cekur.
5. Kopja e letërnjoftimit .
6. Konfirmim nga banka për xhirollogarinë bankare, e cila llogari duhet të jetë aktive. Llogaria bankare duhet të jetë e vet studentit që aplikon.
7. Të gjitha dokumentet që kërkohen me UA. 14/2017, duhet të jenë origjinale dhe të lëshuara nga organet kompetente.

Procedurat e aplikimit

- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet në MASHT- Zyra e protokollit.
 - Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.
 - Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASHT.
1. Konkursi do të jetë i hapur 10 ditë nga data e shpalljes.
 2. Në qoftë se gjatë kohëzgjatjes së afatit të aplikimit ka ditë feste, atëherë afati i aplikimit do të shtyhet për aq ditë sa zgjatë festa zyrtare